



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.373/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Faton Ademi dhe Adnan Konushevi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Afërdita Misimi nga Prishtina, për shkak të rishikimit të fletëvotimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e pa lejuar ankesa Anr.373/2019, e datës 16.10.2019, e parashtruar nga Afërdita Misimi nga Prishtina, për shkak të rishikimit të fletëvotimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019.

A r s y e t i m

Me datën 16.10.2019, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.373/2019, ndërsa me datë 17.10.2019 plotësimin në ankesë, të parashtruar nga Afërdita Misimi, në të cilën kërkon nga KQZ, PZAP dhe OSBE ti gjendet fletorja ku shkruan emri i saj Afërdita Misimi dhe te nënës së saj Fetije Bislim Misimi e cila ka vdekur me datën 19.04.2019 dhe është çregjistruar në regjistrat përkatës të Komunës së Prishtinës dhe Lipjanit.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese lidhur me rishikimin e fletores së nënshkrimeve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, është i palejuar.

Në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe te pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë PZAP-i vlerësoj se ankesa e ankueses është e palejuar për faktin se PZAP-i nuk mundi të veproj sipas ankesës së ankueses, në kuptim të nenit të lartëcekur.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.373/2019 më datën 18.10.2019

Kryesuese e Panelit
Gyltana Sylejmani



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.